

PJESA B: KONTRATA¹ & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

DATE: 04.12.2020.

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"LIMITPROJECT -SH.P.K & DELTA-CCD-SH.P.K & RINESA-SH.P.K-Prishtine, ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:
Pastrimi dhe rregullimi i liqenit në fshatin Brezne (RITENDERIM)

me numër identifikues: 621-20-7143-5-2-1, dhe nr, te mbrendshem 621-2020-153-521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Pastrimi dhe rregullimi i liqenit në fshatin Brezne (RITENDERIM)

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **36,983.00 €; (tridhjet e gjashte mij e nenteqind e tetedhjete e tre Euro).**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Para nënshkrimit të Kontratës "kjo Draft Kontrate" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit



Neni 4 Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [[angleze][shqipe][serbe]² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Nuro Ismaili 153 R ^c
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	04.12.2020.
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	" LIMITPROJECT – SH.P.K & DELTA- CCD-SH.P.K & RINESA-SH.P.K- Prishtine
Pozita:	menagjer
Nënshkrimi:	
Data:	04.12.2020
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **"Punë"** konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 **"Kontraktuesi"** është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 **"Menaxheri i Projektit"** është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 **"Çmimi Kontratës"** do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 **"Vendi i ndërtimit"** do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 **"Pajisjet e kontraktuesit"** do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 **"Skicat"** nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontrktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

Obligimet e Kontraktuesit

Neni 86 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se

kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të **Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm**.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materiale, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësura.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohej për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatoheshin, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojë Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punëve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skemën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohej nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rrugë ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen në kryerjen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masë të veçantë që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuar në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbris dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

Materialet dhe mjeshtëritë

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistrin. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në punë.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në punë ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në punë vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "*Menaxherin e Projektit*", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendpunishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tilla ose te përjashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigjojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve qe duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do te tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jetë rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimit përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;

- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrimi;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përqipen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuhët në përdorim zyrtarë .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>[shëno shumën e sigurisë së ekzekutimit]</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Planin për Menaxhimin e Kontratës. Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <u>2 ditëve</u> nga data e Nënshkrimit të kontratës.....
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : 2 (Dy) ditë pas nënshkrimit të kontratës, nëse kushtet atmosferike janë të përshtatshme (vlerësimi i Organit Mbikëqyrës të Autoritetit Kontraktues
	17.2	Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës : deri me date 22.12.2020.
Dëmet e likuiduara	19.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.

Regjistri i punës	20.1	[Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk është nevojitet].
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni I Pranimit të punëve – shërbimeve, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të punëve-shërbimeve të Autoritetit Kontraktues Menagjer I kontrates nga AK është: Bean Haxhiasi Menagjer I projektit nga AK është: Sabahat Hasani Menagjer I projektit nga OE është: Ekrem Tahiraj
Pagesa	24.2	Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit- situacioneve të aprovuara nga ana e Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit deri në 70 % të projektit, pagesa do të kryhet në afate sa më të shkurtë kohor dhe jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të faturës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: Nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: [shëno përqindjen]
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm. Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti të lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vleren e pergjithëshme të kontratës, me afat validiteti për prej 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të

me gjyqësore	procedurë	dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.
-----------------	-----------	--


A		PARAMASA DHE PARALOGARIA PËR NDËRTIMIN E PORTËS SHKARKUESE DHE KANALEVE DEVIJUESE NË LIQENIN E BREZNES			
PUNIME PARAPREGADITORE					
Nr.	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithësej (€)
Gërmimi i dheut me vegla dore te dheut të kategoris se IV, V dhe VII për ndërtimin e kanaleve devijuese dhe shkarkuese. Gërmimet e terenit do të kryhen në bazë të detaleve teknike duke i rrespektuar kuoat dhe disnivelet ashtu siq është përcaktuar në tender. Dheu i gërmuar hudhet në afësi të zones kufizuese, sipas nevojës një pjesë e dheut kthehet përsëri tek muret e kanaleve devijuese dhe shkarkuese aty ku ka nevojë të mbushet zona e gërmuar, pjesa e dheut të tepërt largohet në Deponin e përcaktuar nga organi mbikqyrës. Së bashku me organin mbikqyrës gërmimet regjistrohen në librat e ndërtimit, do të bëhet llogaritja e vërtetë e sasive. Nëse gjatë gërmimeve arrijn deri të shembjet e mundeshme aksidentale apo nga pakujdesia e cila vjen deri të rrezikimi, rrezikimin e personelit të punës për mosrrespektimit të kritereve të përcaktuar të sigurisë, përgjegjësin e mban kontraktori (punëkryesori) i cili do t'i bartë të gjithashpenzimet për të sjellur në gjendje e mepareshme te terenit ashtu siq ka qene para fillimit te puneve. Gjatë kalkulimit të çmimeve duhet llogaritur edhe testimin e moduleve të arritura të ngjeshmërisë të materialeve të tokës dhe duke i dhënë certifikata e atestit lidhur me arrijten e modulit te ngjeshjes. I cili nuk duhet të jetë më i vogël se Ms= 400 Kg/cm2					
1.1	Pastrimi i terenit me vegla dore nga drunjet dhe bimësitë dhe materiale të tjera të ngurta në zonën ku do të vendoset porta me kanale devijuese dhe shkarkuese. Në këtë pozicion përfshihet edhe rregullimi brigjeve të liqenit të breznes në zonën e punimeve të portës shkarkuese dhe kanaleve devijuese, material i tepërt largohet dhe transportohet deri në deponinë më të afërt të përcaktuar nga organi mbikqyrës llogaritja në m2 të punimeve.	m2	35	4.00 €	140.00 €
1.2	Shenimi i objektit hidroteknikë për mbyllje dhe shkarkim të ujit të liqenit, shenjëzimi i akseve dhe vendosja e piketimit horizontal dhe vertikal, në mënyrë që përcaktohen qartë pozicionimi i vendosjes së kanalit shkarkues së bashku me portën me mekanizë hapës dhe mbyllës nga çeliku i galvanizuar, kanalit devijues si dhe atij shkarkues për nevoja emergjentet duke i llogaritur edhe disnivelet e kapërderdhësit ku do të shkarkohet rrjedhja e ujit nga liqeni. Llogaritja në m2 me të gjitha shpenzimet.	m2	35	30.00 €	1,050.00 €
1.3	Gërmimet me vegla dore, në një hapsirë të gjerë, në kategorinë së dheut III-VII (Toke Lumore) me një ramje të cepët ansore 1:10. Dheu i gërmuar largohet anash një 2 m nga cepet e gërmimit. Pasi të jetë kryer gërmimi i gjerë i dheut faqet anësore skarpatet punohen me dorë, edhe në sipërfaqen e poshtme të gërmimit rrefshohen - nivelizohen dhe ngjeshet me makinë vibruese. Thëllësia e gërmimit bëhet në bazë disniveleve të kapërderdhësit lumorë dhe kuotave gjeodezike të përfshira në detalin teknik të kanalit shkarkues së bashku me portën me mekanizë hapës dhe mbyllës nga çeliku i galvanizuar duke përfshirë edhe themelet. Llogaritja në m3.	m3	24	9 €	216.00 €
1.7	Gërmimet me vegla dore të dheut të kategorisë III, IV dhe VII për hapjen e dheut për ndërtimin e kanalit devijues si dhe atij shkarkues vendosjen dhe montimin e gypave shkarkues sipas detalin teknike të përfshirë në projekt. Anë e kanalit të gërmuara gërmohen me pjerris në 1/10. Fundi i kanalit duhet të rrafshohet me saktësi prej ± 1 cm. Gjatësia mesatare deri në 50m. Llogaritja në m3, ku në çmim përfshihet edhe largimi i dheut të tepër deri në deponinë më të afërt me koordinim me organin mbikqyrës.	m3	37.5	9 €	337.50 €
1.8	Furnizimi, transporti, mbushja dhe hedhja, shtrirja e zhavorit (guri) i thyer fra 0-63mm me perberje natyrore, në një trashësi shtresë d = 10+15cm. Në këtë pozicion përfshihet hudhja e zhavorit në bazën e themeleve të kanalit shkarkues së bashku me portën me mekanizë hapës dhe mbyllës nga çeliku i galvanizuar, kanalit devijues si dhe atij shkarkues për nevoja emergjentet duke i llogaritur edhe disnivelet e kapërderdhësit sipas detaleve teknike të përfshira në projekt. Ngjeshja kryhet me sperkatje me ujë dhe pastaj deri të ngjeshja e kërkuar, të paktën 150 MPa / m3 do të bëhet para se të hudhet beton..	m3	10	9 €	90.00 €
1.9	Furnizimi dhe shtrirja e dheut të gërmuar të tepërt rreth kanaleve shkarkuese dhe devijues duke përfshirë dhe kapërderdhësin pas përfundimit të punimeve dhe kthimin e terenit në gjendje të më parshme. Llogaritja në m3.	m3	6	6.00 €	36.00 €
1.10	Furnizimi dhe shtrirja e Rërës 0-1mm, trashësi 10cm për shtratin nën gyp me planifikim ±3cm, dhe 15 mbi gyp për mbulimin dhe mbrojtjen e gypit, sipas vërejtjeve dhe përshkrimeve teknike paraprake të specifikuar për punimet tokësore. Gjatë vendosjes së rërës të aplikohet glanumetria të përcaktuar në bazë të rregullave dhe standardeve për aplikimin të materialeve ndërtimore në vepër. Ngjeshja sipas normave DIN, DPr 103% llog m3.	m3	7.5	9.00 €	67.50 €
1.11	Largimi e ujërave të lumit me pompë apo devijimin e rrjedhjes së ujit të liqenit në mënyrë që punimet të realizohen normalisht konform standardeve, mbi rrjedhjen e lumi pa pasur pengesa. Llogaritja në m3 të gjitha shpenzimet.	komplet	1	200.00 €	200.00 €
2	GJITHËSEJ PUNET PARAPREGADITORE PUNËT E LATUSE NË KANALET NIKULOME DHE KANALEVE FURNIZUES, DEVIJUESE DHE SHKARKUESE				2,137.00 €



2 PUNËT LATUESE					
Nr.	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithësej (€)
2.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i pahive prej druri për sigurimin e hendekut/gropës ndërtimore ku do të ndërtohet kanali shkarkues së bashku me portën me mekanizë hapës dhe mbyllës nga çeliku i galvanizuar, kanali devijues si dhe atij shkarkues për nevoja emergjentet duke i llogaritur edhe disnivelet e kapërdërdhësit me dimensione sipas detaleve teknike të përfshira në projekt nga shembjet e mundeshme. Gjatë montimit pahive duhet aplikohen mekanizma me mundësi të demontimit të lehtë pas përfundimit të punime. Gjatësia mesatare e 10m për sigurimin në rast zgjerimit. Llogaritja në m2 të punimeve.	m2	45	10 €	450.00 €
GJITHËSEJ PUNËT LATUESE					450.00 €
3 PUNËT E BETONIT					
Nr.	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithësej (€)
3.1	Furnizimi, kallupimi dhe Betonimi i shtresës së varfër të tamponit me C-20/25, me një trashësi prej 5 cm. Tamponi i vendosur mbi shtresën e parapërgatitur me shtresë të zhavorrit pas atestimit të Modullit të ngjeshjes. Llogaritja në m3.	m3	2	75 €	150.00 €
3.2	Furnizimi, kallupimi dhe Betonimi i themeleve kanali shkarkues së bashku me portën me mekanizë hapës dhe mbyllës nga çeliku i galvanizuar, kanali devijues si dhe atij shkarkues për nevoja emergjentet duke i llogaritur edhe disnivelet e kapërdërdhësit me dimensione sipas detaleve teknike të përfshira në projekt nga betoni i armuar klasa C30/37. Reqetës së betonit duhet të shtohen aditive me qellim që masa e betonit krijohet e pa papërshkeshme nga uji dhe rezistente ndaj ngricave. Para hüdhes në vepër të betonit duhet të matet konsistenca dhe të hüdhet në vepër në përputhje me teknologjinë betonit, si dhe rregulloret dhe standardet Eurocod 9001/2008. Ekzekutimi i punimeve duhet të bëhet në përputhje me detalet teknike të përfshira në projekt. Llogaritja në m3 për beton arme, armimi i themeleve pllakë duhet të bëhet në përputhje me dimensionimin dhe detalin e armimit të përfshirë në projekt. Vërejtje: Betoni i shtohet Aditiv lëngëzues për beton hidrozolues mase (ASTM C-494 I tipit A, ELOT EN 934-2: T2 & T9 apo të ngjashme nga produktet vendore). I shtuar tek betoni i jep veti plastifikuese dhe përmirëson rezistencën ndaj përshkueshmërisë nga uji rrit papërshkueshmërinë nga uji, rezistentë nga ciklueset (ngjirje-shkrirje) dhe kripërave dhe acidëve W - 347, ISO 8467.	m3	8	100 €	800.00 €
3.3	Furnizimi, kallupimi dhe Betonimi i pllakës së bazamentit të kapërdërdhësit të kanalit shkarkues me dim 0.50 mx 1.60m me trashësi të ndryshueshme të pllakës së bazamentit si dhe kanaleve (Furnizimi, devijimi dhe shkarkimi) mbi themelin pllakë në pjesën e poshtme të kthines grumbulluese dhe shkarkuese të ujit ku janë të vendosura porta mbyllëse dhe hapëse me teleskop sipas detaleve teknike të projektit, me klase betoni C 25/30. Reqetës së betonit duhet të shtohen aditive me qellim që masa e betonit krijohet e pa papërshkeshme nga uji dhe rezistente ndaj ngricave. Para hüdhes në vepër të betonit duhet të matet konsistenca dhe të hüdhet në vepër në përputhje me teknologjinë betonit, si dhe rregulloret dhe standardet Eurocod 9001/2008. Ekzekutimi i punimeve duhet të bëhet në përputhje me detalet teknike të përfshira në projekt. Llogaritja në m3 për beton arme, armimi i kësaj pllake duhet të bëhet në përputhje me dimensionimin dhe detalin e armimit të përfshirë në projekt. Vërejtje: Betoni i	m3	14	90.00 €	1,260.00 €



3.4	Furnizimi, kallupimi dhe Betonimi i mureve në faza të kapërdedhësi të kanalit shkarkues, sipas dizajnit dhe detaleve teknike të projektit, me klase betoni C 25/30, me trashësi d = 25 cm . Reçetës së betonit duhet të shtohen additive me qëllim që masa e betonit krijohet e pa papërkeshme nga uji dhe rezistente ndaj ngricave. Para hüdhes në vepër të betonit duhet të matet konsistenaca dhe të hüdhet në vepër në përputhje me teknologjinë betonit, si dhe rregulloret dhe standardet Eurocod 9001/2008. Ekzekutimi i punimeve duhet të bëhet në përputhje me detalet teknike të përfshira në projekt. Llogaritja në m3 për beton armë , armimi i mureve të objektit stacionit pompimit duhet të bëhet në përputhje me dimensionimin dhe detallin e armimit të përfshirë në projekt , duke përfshirë edhe përfshirimin e kolimit të ujit për kalim tranzit të ujit nga kanalet furnizues në gypin e furnizimit të ujëmbledhësit. Gjatë krijimit të mureve të njëjtën kohë të formohen vatat horizontale dhe vertikale. Vërejtje: Betoni i shtohet Aditiv lëngëzues për beton hidroizolues mase (ASTM C-494 i tipit A, ELOT EN 934-2:T2 & T9 apo të ngjashme nga produktet vendore). I shtuar tek betoni i jep veti plastifikuese dhe përmirëson rezistencën ndaj përshkueshmërisë nga uji irit papërkeshmërinë nga uji, rezistentë nga ciklueset (ngjirje-shkriirje) dhe kripërave dhe acidëve W - 347, ISO 8467. Llog në m3 në këtë pozicion janë të përfshira edhe betonimi i mureve të kanaleve furnizimit, devijimi dhe shkarkimit, me dimensione sipas projektit ku janë të përfshira të gjitha shpenzimet në funksionimin e plotë të projektit. Llogaritja në m3.	m3	25	130.00 €	3,250.00 €
3.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e gureve të mveshjes së mureve dhe kanalit devijues të kapërdedhësit mbi lumë me gurë (B =33 m1),për mbrojtjen e pllakës së betonit të kanalit devijues nga erozion apo valëve goditëse , të punohet sipas detaleve teknike të projektit. Gurët të jenë aluvial me madhësi dhe formë me dim rreth 50 cm ,të punohet ramja në drejtimin e rrjedhës të ujit të liqenit me 4% si dhe të përforcohen me beton të pa përshkueshëm nga uji dhe të rezistueshëm ndaj ciklueset (Ngjirje ,shkriirje) .Llog në m2 me të gjitha shpenzimet.	m2	12	50.00 €	600.00 €
3.7	Furnizimi, transporti dhe vendosja dhe palimi i gurëve natyral stabilizues me trashësi d= 50 cm me me vegla dore fuqi punëtore për punime në ujë duke siguruar kushte të përshtatshme për punë, me qëllim të sigurtimit të themelvet të kaptazhëa nga erozioni dhe valët goditëse të lumit në drejtim të rrjedhës gjatë vërshimeve. Punët të kryhen sipas detaleve teknike të prezentuara në projekt. Llog në m3 me të gjitha shpenzimet .	m2	8	50.00 €	400.00 €
GJITHËSEJ PUNIMET E BETONIT					6,460.00 €
4 PUNIMET E ARMIRUESEVE					2,256.00 €
Nr.	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithësej (€)
4.1	Punimi i armaturës sipas detaleve teknike dhe detaleve të armimit të përfshira në projekt sipas llogaritjes statike. Në çmim përfshihen të gjitha operacionet e punës dhe furnizimi dhe perdorimi i materialeve dhe mjeteve ndihmëse, sipas nevojës edhe vendosja e skeleve, si dhe shpenzimet e tjera të nevojshme. Armirimi të punohet nga hekuri ndërtimor i paraparë në llogarinë statike duke i aplikuar "Rregulloret për standardet teknike për beton dhe beton të armuar" Eurocod 9001/2008 dhe standardet e aplikueshme për hekur të betonit. Hekuri ndërtimor para se të vendoset në vepër duhet pastruar nga ndryshku dhe korezloni i papastër, të drejtohet, të prehet, të lakohet dhe të bëhet montimi në detaje (vizatime të				
4.2	Furnizimi i hekurit ndërtimor, pastrimi, prerja, përpunimi dhe montimi i armatures të hekurit të brinjëzuar, të gjitha në përputhje me llogaritjen statike sipas detaleve teknike të armimit të përfshira në projekt. Llogaritja në kg.Llogaritja në kg. Në çmim përfshihet transporti me mjete alternative kuaj , traktorë deri aty ku ka mundësi të depëroj pasaj me dorë duke angazhuar fuqinë punëtore deri në punishte	kg	3760	0.60 €	2,256.00 €
GJITHËSEJ PUNIMET E ARMIRUESVE					2,256.00 €
5 PUNIMET E AXHYSTATORËVE					350.00 €
5.3	Furnizimi dhe montimi i mbyllsive nga materiali metal gusit me dim :50x50 cm të mbrojtur me ngjyrë anti korrozive ,rezistente ndaj kushteve atmosferike , i pajisur me portë mbyllëse dhe mekanizem të tipit valvule mekanike për hapje dhe mbyllje të portës në drejtimin vertikal , për mbyllje dhe shkarkime të ujit të liqenit për raste emergjente sipas detalit teknik të përfshirë në projekt.. Llog në komplet	komplet	1	350 €	350.00 €
GJITHËSEJ PUNIMET E AXHYSTATORËVE					350.00 €
6 PUNËT E HIDROIZOLIMIT					
Punimet për hidroizolim dy shtresorë do të kryhen në përputhje me projektin, përshkrimet teknike si dhe standardet e aplikueshme si : Standardin ASTM 494 Tip F - Standard për shtuarjen e additiveve që krijojnë shtresë e papërkeshme nga uji në zonën ku bëhet izolimi i sipërfaqës, Standardi DIN 4030 për aplikimin e materialeve hidroizoluese , në çmim përfshihen të gjitha operacionet e punës, blerjes dhe shfrytëzimit të materialit, mjete shtesë, si dhe vendosjen e skeleve. Në çmim llogaritet transporti bëhet me mjete alternative kuaj , traktorë deri aty ku ka mundësi të depëroj pasaj me dorë duke angazhuar fuqinë punëtore deri në punishte për secilin pozicion të hidroizolimit.					



6.1	Furnizim dhe montimi i shtresës izoluese të hidroizolimit me material hidroizoluese sipas standardeve të aplikueshme të cekur në specifikacionin teknik duke aplikuar material hidroizolues me trashësi 4 mm, vendosja bëhet në të gjithë sipërfaqen e mureve bazamentit, kanaleve devijuese dhe shkarkuese, te kapërderdhisi, si dhe të zona e mbyllsit, aty ku është mbuluar izolimi me shtresë filestare me bitullit. Materiali hidroizolues vendoset mbi sipërfaqen izoluese të bitullit, vendosje e materialit hidroizolues Index bëhet me saldim me flakë. Llog në m2	m2	60	20 €	1,200.00 €
6.2	Vendosja e folisë PVC për mbrojtjen e shtresave hidroizoluese. Llog në m2	m2	60	1.5 €	90.00 €
GIJTHËSEJ PUNIMET E HIDROIZOLIMIT					1,290.00 €
7	PUNËT FINALE TË KAPËRDERDHËSIT DHE KANALET DEVIJUESE DHE SHKARKUESE				
7.1	Pastrimi i terrenit, largimi i mbeturinave dhe gjesendeve ndërtimore pas përfundimit të punimeve dhe kthimin në gjendje të mëparshme të terrenit	m2	50	5.0	250.00 €
GIJTHËSEJ PUNET TË KAPËRDERDHËSIT DHE KANALET DEVIJUESE DHE SHKARKUESE					250.00 €
REKAPITULIMI - RECAPITULATION					
1	PUNIME PARAPREGADITORE				2,137.00 €
2	PUNËT E LATUSE NË KAPTAZHË MBI LUMË DHE KANALET FURNIZUES, DEVIJUESE DHE SHKARKUESE				450.00 €
3	PUNËT E BETONIT				6,460.00 €
4	PUNIMET E ARMIRUESEVE				2,256.00 €
5	PUNIMET E AXHYSTATORËVE				350.00 €
6	PUNËT E HIDROIZOLIMIT				1,290.00 €
7	PUNËT FINALE TË KAPËRDERDHËSIT DHE KANALET DEVIJUESE DHE SHKARKUESE				250.00 €
TOTALI					13,193.00 €

B	PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR PUNIMIN E SHTIGJEVE TË ECJES NË BRIGJET E LIQENIT BREZNE
----------	---

P01	Punët përgatitore				
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi [€]	Shuma [€]
Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit, Kompania punëkryese është përgjegjëse për t'i marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet shpalluese para fillimit të punëve në gjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore, si dhe të qytetarëve është e obliguar t'i kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare.					
1.1	Shënim i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet traseja e rrugës fushore sipas projektit detaj gjatë kohës së zgjatit punimet. Shënjëzimi të bëhet në fillimet e shtrimit të shtigjeve.	m2	525.00	0.50	262.50 €
1.2	Punët parapërgatitore, shënim i shtigjeve, si dhe elemente përcjellëse në bazë të projektit zbatues. Në matjet gleodezike të përfshihen të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike.	m2	525.00	0.50	262.50 €
1.3	Ekzaminimi i materialeve para dhe pas vuarjes në vepër të tyre si psh. kallidremit, porfidos, kubëzave elementeve të tjera për shqyrtim si dhe prejardhjen e tyre. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe preardhjen e materialit para fillimit të punimeve.	komplet	1.00	150.00	150.00 €
P01 Total:				675.00 €	

P02	Punët demoluese				
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi [€]	Shuma [€]
2.1	Pastrimi i terrenit nga mbeturinat e ngurta, shkurret dhe drunjët dhe hapja e kanaleve anësore, dhe lëshesave në rast të mungesës së tyre. Pastrimi i tyre bëhet normal me drejtimin e shtigjeve me gjerësi të përcaktuar me projekt. Ky pozicion përfshinë edhe largimin e mbeturinave në deponi. Deponimin e materialit të demoluar e cakton Investitori.	m2	525.00	0.50	262.50 €
P02 Total:					262.50 €

P03	Punët tokësore					
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi [€]	Shuma [€]	



3.1	Gërmimi, hapja e kanaleve kulluese për kullimin e zonës ku do të ndërtohen shtigjet e gjelbërta. Ngjeshja e dheut në terë sipërfaqet e shtegut pas gërmimit në të njëjtin nivel. Ngjeshja të bëhet me cilindër deri sa të arrihet ngjeshmeria 40KN/m2. Në këtë pozicion të kalkulohet edhe vendosja e shtresës gjeo-tekstil për stabilizimin e terrenit. Llog në m3 me të gjitha shpenzimet.	m3	900.00	2.00	1,800.00 €
	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës stabilizuese për shtigjet e ecjes me natyral pa fraksion 120- 500 mm për stabilizimin e tokës moqalore ku ka mu ndërtura shtigjet e ecjes , me trashësi të shtresës t=60-120 cm të cilat i plotëson kushtet e parapara për tampon si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=600 kg/cm2 . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.	m3	900.00	5.00	4,500.00 €
3.2	Furnizimi, transportimi, shtruarja dhe ngjeshja e nën bazës me shtresë zhavorrit të granular te fraksionit 0-64mm në trashësi t=30cm, si bazë për shtruarjen e kalldrimit dhe kubzave në shtigjet e nënkalasë sipas projektit. Ngjeshja të bëhet me cilindër vibrues deri sa të arrihet moduli i deformimit Mv= 250 kg/cm2. Në kalkulim të përfshihet edhe matja dhe shqyrtimi i modulit të ngjeshjes, nga ekipi i specializuar. Vërejtje: Pas përfundimit të kësaj shtrese, kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj atë te menaxheri kontratës.	m3	180.00	6.00	1,080.00 €
3.3	Furnizimi, transportimi dhe shtruarja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rërë të imët nga guri i thyer me fraksion 0-31.5 mm me trashësi të shtresës t=5 cm, si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv = 500 kg/cm2. Vërejtje: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj atë te menaxheri kontratës.	m3	52.50	9.00	472.50 €

P04	Punët mbistrukturës	P03Total:		7,852.50 €	
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi [€]	Shuma [€]
4.1	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e kubzave të betonit t=8cm si kurse ato ekzistuese katrore ngjyrë e kuqe, C-35/37 në shtresë rërë frak. (4-8)mm me t=5cm dhe mbushja e fugave me rërë, duke përfshirë edhe zgjerimet dhe kyqjet në rrugë. Llog në m2	m2	450.00	5.00	2,250.00 €
4.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e skajoreve në bazament betoni me dlm.15x22x100cm, C-35/37.	m'	300.00	6.00	1,800.00 €
P04 Total:				4,050.00 €	

P05		Mobilari urban			
Nr.		Përshkrimi			
5.1	Furnizimi, transportimi dhe montimi i mbajtësve metalike të galvanizuar të zona portës shkarkuese dhe kanaleve devijuese shkarkuese , me qëllim që njerz apo gjallesa të ndryshme mos bien në kanal shkarkues Të gjitha punët si dhe përzgjedhja të bëhet nga organi mbikqyrës.	Njësia	Sasia	Çmimi [€]	Shuma [€]
		m'	20.00	15.00	300.00 €
5.2	Furnizimi, transportimi dhe montimi i ulësve të qëndrueshme ndaj vandallizmit, sikurse ato ekzistuese . Në kalkulim të përfshihen të gjitha materialet dhe elementet e nevojshme për punimin dhe montimin e ulësve. Përzgjedhja e ulësve të bëhet në pajtim me dhe në udhëzimet të organit mbikqyrës.	copë	10.00	250.00	2,500.00 €
5.3	Furnizimi, transportimi dhe vendosja e shportave për plehra. Propozohet të vendoset shporata me material druri dhe çeliku me lartësi minimale H: 850 mm dhe kapacitet 50 lt. Përzgjedhja e shportave për plehra të bëhet në pajtim me dhe në udhëzimet të organit mbikqyrës.	copë	12.00	45.00	540.00 €
P05 Total:			3,340.00 €		

REKAPITULLIM I PUNIMEVE TË SHYTGJIEVE TË ECJES					
1	Punët përgatitore				
2	Punët demoluese				675.00 €
3	Punët tokësore				262.50 €
4	Punët e mbistrukturës				7,852.50 €
5	Mobilari urban				4,050.00 €
					3,340.00 €
				TOTALI ME TVSH [€]:	16,180.00 €




16180,00

C					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR PUNIMIN E NDRIÇIMI TË SHTIGJEVE TË ECJES					
POS 1	PUNËT PARAPREGADITORE DHE PUNËT E DHEUT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma (€)
1.1.1	Identifikimi i instalimeve nëntokësore dhe mbetësore (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonike dhe internetit), pikturimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qëllim të evitimit të parandalimit të dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit, dëmtimet e aseteve dhe shkyqjen të furnizimeve në masë të popullatës në afërsi të vendbanimeve ku kalon traseja e re e rruges së projektuar. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimit për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terentit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin e trases së re të rrugës . Llog m2	m'	150	1.00 €	150.00 €
1.1.2	Punët përgatitore - përfundimtare duke përfshirë edhe organizimin e punës, bartjen e pajisjes dhe mekanizmit në teren. Në fund pastrimi i terentit nga mbeturinat e bëra gjatë punës.	m'	150	1.00 €	150.00 €
1.1.3	Mihja e kanalit në shtegun e ecjes me dimensione 0.7x1.0m për vendosjen e kabllave të ndriçimit ,kablrat të rrjetit 0.4Kv , gypave rezervë dhe shiriti përtozues sipas detalit gjegjës	m3	105	3.00 €	315.00 €
1.1.4	Shtrirja e reres ne trashesi (10+10)cm rroth kabllave dhe gypave	m3	30.0	9.00 €	270.00 €
1.1.5	Mbushja e kanaleve me dhe ne shtresa duke e ngjeshur ate ne çdo 20cm.	m'	150.0	2.00 €	300.00 €
1.1.6	Largimi i dheut të tepërt nga shtegu i ecjes dhe bartja e tij deri në Deponin e Qytetit	m'	150.0	2.00 €	300.00 €
1.1.7	Porositja, transporti dhe montimi i shiritit për vërejtje nga PVC me gjeresi 40cm dhe trashësi 0,25mm. Shiriti duhet te mbaj shenimin: "Kujdes, rrezik nga tensioni i Hartë".	m'	150.0	1.50 €	225.00 €
1.1.8	Punimi i bazamentit për përfundimin e tabelës së ndriçimit nga betoni i tipit C25/30. Bazamenti ka këto dimensione : (90x50x60) cm . Në bazament duhet të vendosen bulonat për ankerimin e tabelës. Çmimi i pjet për komplet bazamentin	Copë	1.0	100.00 €	100.00 €
P01 Total:				1,810.00 €	

POS 2					
PUNËT E ELEKTRIFIKIMIT					
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma (€)
2.1.1	Furnizimi dhe vendosja e shtyllave metalike të ndriçimit, me derë për hapje dhe trashësi të mureve konform standardeve për zonë të II-të të erës. Shtyllat e NP të jenë nga materiali ST 37 (S235 JR), të galvanizuara sipas standardit: EN ISO 1461, konike, njëtrajtësisht të punuara (pa saldime të pjesëve). Sk. 1	copë	6.0	100.00 €	600.00 €
2.1.2	Furnizimi dhe vendosja e lirave standarde me gjatësi të krahut; Lmax=2.5m, nga materiali ST 37 (S235 JR) të galvanizuara, rrethore ose këndore të një anshme	copë	6.0	50.00 €	300.00 €
2.1.3	Blerja, bartja dhe montimi i llampave per ndriçim publik te tipit AVENUE 2 -Gewiss ose te ngjashme me poqe Natriumi me fuqi 150W.Llampat duhet te kenë mbrojtje IP65.	copë	6.0	50.00 €	300.00 €
2.1.6	Blerja, bartja shtrirja dhe lidhja e kabllot NAYY 4x16mm² nga shtylla ne shtyllë si dhe lidhja ne tabelen e ndriçimit.	m	150.0	5.00 €	750.00 €
2.1.7	Blerja, bartja shtrirja dhe lidhja e kabllot NAYY 4x25mm² per furnizimin e tabelave te ndriçimit.	m	150.0	4.00 €	600.00 €
2.1.8	Porositja, transporti dhe montimi i shiritit të tokëzuesit per pertokzim të llampave dhe shtyllave fundore me dim: Fe/Zn25x4mm.	m	150.0	5.00 €	750.00 €
2.1.9	Porositja, transporti dhe montimi papugeve Al/Cu16/Φ8 per kabla te ndriçimit.	m	150.0	4.00 €	600.00 €
2.1.12	Blerja, bartja shtrirja dhe lidhja e kabllot se tensionit 10(20)kv tip XHP-A 1x120mm² nga trafostacioni	m	500.0	3.70 €	1,850.00 €
2.1.19	Matja , shqyrtimi dhe testimi i rrjetit elektrik , marrjen e pëlqimeve nga KEDS	komplet	1.0	50.00 €	50.00 €
P02 Total:				5,800.00 €	

REKAPITULLIM I PUNIMEVE TË NDRIÇIMIT		
1	PUNËT PARAPREGADITORE DHE PUNËT E DHEUT	1,810.00 €
2	PUNËT E ELEKTRIFIKIMIT	5,800.00 €



	Totali me TVSH	7,610.00 €
--	----------------	------------

REKAPITULIMI I PËRGJITHSHËM

A	PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR NDËRTIMIN E PORTËS SHKARKUESE DHE KANALEVE DEVIJUESE NË LIQENIN E BREZNES	13,193.00 €
B	PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR PUNIMIN E NDRIÇIMI TË SHTIGJEVE TË ECJES	16,180.00 €
C	PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR PUNIMIN E NDRIÇIMI TË SHTIGJEVE TË ECJES	7,610.00 €
	TOTALI ME TVSH	36,983.00 €

